



Zbuloni gjuhën tuaj të dashurisë Pyetsori për gratë



Fjalët Përgëzuese, Koha Cilësore, Dhuratat, Veprat e Shërbimit, apo Prekja Fizike? Cila prej tyre është gjuha juaj parësore e dashurisë? Pyetëtori I mëposhtëm do t'ju ndihmojë ta dini me siguri se cila është gjuha juaj e dashurisë. Pastaj bashkë me burrin tuaj diskutoni gjuhët tuaja parësore të dashurisë dhe përdoreni këtë informacion për të përmirësuar martesën tuaj.

Pyetsori përbëhet nga 20 grupe thëniesh. Mund të zgjidhni vetëm njërën pikë në secilin grupim. Lexoni secilin grupim dhe në kolonën në të djathtë, rrethoni gërmën që përputhet me thënien që zgjidhni. Ndonjëherë mund të jetë e vështirë për të vendosur midis dy mundësive, por duhet të zgjidhni vetëm një për rezultate të sakta të pyetsorit.

Merrni 20–30 minuta kohë për të plotësuar pyetsorin. Pasi të keni rrethuar zgjedhjen tuaj numëroni sa herë keni rrethuar secilën gërmë. Në fund të pyetsorit shkruani numrin që tregon sa herë e keni rrethuar atë gërmë.

1. Më pëlqen:

- Të marr kartolina dashuri nga burri im C
- Të marr përqaftime nga burri im E
- Të kaloj kohë vetëm me burrin tim B

2. Ndjem e dashuruar nëse:

- Burri do të më ndihmojë me fëmijët kur jam e lodhur D
- Burri do të më bëjë dhurata C
- Do të shkojmë së bashku në udhëtime të gjata B

3. Ndjem e dashuruar nëse burri:

- Do të më ndihmojë me larjen e rrobave D
- Do të më përkëdhelte E
- Do të më bëjë dhurata surprizë C

4. Zgjidh njërën nga të treja:

- Nuk ka rëndësi se ku shkoj mjafton të jem me burrin B
- Do të ndjem e dashuruar nëse im shoq do të më kapi përdore E
- Vlerësoj nëse burri do të më japë dhurata C

5. Ndjem e dashuruar nëse:

- Burri do të më hedh dorën në qafë E
- Burri do të më thotë të dua A
- Burri do të më ndihmojë të pastroj tavolinën pas ngrënies D

6. *Më pëlqen:*

- Nëse burri im do të ulet pranë meje B
- Nëse burri do të më thojë se duke mirë A
- Edhe nëse do të marr një dhuratë të vogël nga im shoq C

7. *Më bën të lumtur nëse:*

- Do të kaloj kohë me tim shoq B
- Im shoq më thotë se është krenar për mua A
- Im shoq do të bëj gjëra të vogla për mua sepse kanë më shumë vlerë në sytë e mi D

8. *Ndjehem mirë nëse:*

- Im shoq do të më thojë fjalë inkurajuese A
- Do të bëj gjëra me tim shoq pavarësisht se çfarë gjërash janë ato B
- Do të përqafoj tim shoq E

9. *Më bën të ndjehem mirë nëse:*

- Do të jem pranë burrit E
- Im shoq do të më bëj dhurata që më pëlqejnë C
- Im shoq do të më lavdëronte A

10. *Më pëlqen nëse:*

- Im shoq do të më fërkojë kurrizin E
- Reagimet e tim shoqi ndaj arritjeve të mia do të jenë inkurajuese A
- Im shoq do të më ndihmojë me diçka megjithëse mund të jetë diçka që s'i pëlqen D

11. *Ndjehem ende e gëzuar:*

- Nëse burri do të më puthë E
- Nëse do të hap një dhuratë nga im shoq C
- Nëse im shoq do të më komplimentojë për paraqitjen A

12. *Më pëlqen nëse:*

- Im shoq do të tregoj interes në gjëra që më pëlqejnë mua B
- Mund të mbështetem tek im shoq për disa punë D
- Im shoq do të më japë një dhuratë që të më tregojë se ka menduar për mua C

13. *Zgjidh njërën nga të treja:*

- Do të më pëlqente që im shoq të më dëgjonte dhe të respektonte idetë e mia B
- Më pëlqen ta ledhatoj tim shoq gjithë kohës kur jemi vetëm së bashku E
- Do të më pëlqente nëse im shoq do të më ndihmojë kur kam shumë punë D

14. Më pëlqen nëse:

- Im shoq do të më ndihmojë me pazare dhe të paguaj faturat D
- Im shoq do të më blejë dhuratë të bukur për ditëlindje C
- Im shoq do të më thotë shpesh herë se jam e rëndësishme për të A

15. Më pëlqen nëse:

- Do të kem vëmendjen e plotë të burrit B
- Do të kem ndihmën e burrit për të pastruar shtëpinë D
- Burri do të më tregojë dashur nëpërmjet dhuratave C

16. Më pëlqen nëse:

- Im shoq do të më ndihmojë pa ia kërkuar unë një gjë të tillë D
- Im shoq më dëgjon pa ndërprerje ndërsa flas me të B
- Burri do të më bëjë dhurata të vogla në mënyrë të vazhdueshme C

17. Më pëlqen:

- Nëse im shoq ofron të më ndihmojë kur më sheh që jam e lodhur D
- Nëse shkojmë në vende të ndryshme sëbashku, pavarësisht se ku shkojmë B
- Nëse im shoq do të më përkëdhelë E

18. Më pëlqen nëse:

- Im shoq do të më bëjë dhurata pa ndonjë arsye C
- Im shoq do të më thoshte fjalë inkurajuese që të fitoja vetbesim A
- Do të shikoj film me tim shoq B

19. Do të doja:

- Që im shoq të më përkëdhelte gjithë kohës E
- Që im shoq të më thoshte se më vlerëson A
- Që të merrja nga im shoq dhurata që më pëlqejnë C

20. E vlerësoj nëse:

- Im shoq do të më ndihmojë kur unë jam e ngarkuar me punë D
- Im shoq do të më puthë e përqafojë pasi të kemi qenë larg për një kohë E
- Im shoq do të më thojë se i kam munguar A

A=Fjalët Përgëzuese _____

B=Koha Cilësore _____

C=Dhuratat _____

D=Veprat e Shërbimit _____

E=Prekja Fizike _____

Interpretimi dhe përdorimi i pikëve të pyetsorit

Gjuha juaj parësore e dashurisë është ajo e cila ka numrin më të lartë të pikëve. Zotëroni dy gjuhë nëse rezultati juaj më i lartë i pikëve është i barabartë për dy gjuhë. Kur një gjuhë e dashurisë e cila ka një numër pikësh të përafërt por jo të barabartë me gjuhën e parë të dashurisë, do të thotë se të dyja format e shprehjes së dashurisë janë të rëndësishme për ju.

Mund të keni marrë më shumë pikë në disa prej gjuhëve të dashurisë në krahasim me të tjerat, por mos i trajtoni si të parëndësishme këto gjuhë të tjera. Burri juaj mund të shprehë dashurinë në ato gjuhë, dhe kjo do t'ju ndihmojë ju ta kuptoni atë.

Në të njëjtën mënyrë, do të jetë e dobishme për burrin tuaj të dijë gjuhën tuaj të dashurisë dhe ta shprehë dashurinë për ju në mënyra që ju i kuptoni si dashuri. Sa herë që ju ose burri juaj flisni gjuhën e dashurisë së personit tjetër, ju fitoni pikë emocionale me njëri—tjetrin. Ajo që fitoni kur flisni gjuhën e dashurisë së njëri—tjetrit është një ndjesi lidhjeje më e ngushtë. E thënë ndryshe, është komunikim më i mirë, më shumë mirëkuptim, dhe përfundimisht një romancë edhe më e mirë

